



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.48

24 prill

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i KM nr.2, datë 8.4.2009	Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)	2373
Udhëzim i METE nr.316, datë 8.4.2009	Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr.1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteoze të pasurive shtetërore”	2377
Udhëzim i METE nr.317, datë 8.4.2009	Për procedurat e likuidimit të shoqërive shtetërore	2380
Udhëzim i METE nr.318, datë 8.4.2009	Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore	2382
	Ndreqje gabimi	2385

UDHËZIM
Nr.2, datë 8.4.2009

**PËR MËNYRËN E PROCEDIMIT TË ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE, PËR
PASURITË E PALUAJTSHME, TË FITUARA ME AKTIN E MARRJES SË TOKËS NË
PRONËSI (AMTP)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë” dhe të nenit 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Regjistrimi i fitimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, me aktin e marrjes së tokës në pronësi (në vijim AMTP), të nxjerrë në zbatim të ligjeve nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, të vendimit nr.452, datë 17.10.1992 të Këshillit të Ministrave “Për rristurimin e ndërmarrjeve shtetërore”, të ndryshuar, bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP), në përputhje me nenet 24 e 38 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, pas verifikimit nëse AMTP-ja përmban elementet e mëposhtme, të formës dhe përmbajtjes:

a)Emrin dhe mbiemrin e përfituesit apo të përfaqësuesit të familjes bujqësore, përfituese të tokës bujqësore;

b)Identifikimin e organit që e ka lëshuar AMTP-në (të paktën kërkohet nënshkrimi i kryetarit të komisionit të ndarjes së tokës);

c)Të dhënat identifikuese të pasurisë/ve, të dhëna në pronësi (të paktën kërkohet sipërfaqja, lloji i tokës bujqësore: (arë, pemëtoje, vreshtë, ullishte);

ç)Njërin nga vultat e mëposhtme:

-Vulën e komitetit ekzekutiv të fshatit;

-Vulën e kryeplakut;

-Vulën e komunës/bashkisë;

-Vulën e ndërmarrjes bujqësore;

-Vulën e këshillit të rrethit/këshillit të qarkut.

d)Nëse lloji i pasurisë së disponuar me AMTP, përputhet me ndonjërin nga llojet e pasurive të kadastruara në zërin “tokë bujqësore”, më 1.8.1991, të përcaktuara në shkronjën “a” të nenit 1 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” të ndryshuar;

dh)AMTP-ja është origjinale apo e njësuar me origjinalin nga këshilli i qarkut.

2.Kur pasuria, e përfitur me AMTP në kohën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, figuron e regjistruar në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, veprohet si më poshtë:

2.1Kur pasuria nuk figuron në pronësi të mbajtësit të parë, të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, si pasojë e transaksionit të realizuar me të tretë ose e shpronësimit për interes publik të kryer, me përjashtim të kalimit të pronësisë nëpërmjet akteve të trashëgimisë, e reflektuar kjo në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, këto të fundit, në rastet e trajtimit të kërkesave për shërbim të subjekteve të ndryshme, procedojnë, si më poshtë vijon:

a)Verifikojnë në zbatim të pikës 3 të udhëzimit nr.4, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurës së shirjes së regjistrimeve, të kryera në kundërshtim me ligjin, dhe atyre, që krijojnë mbivendosje në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” ligjshëmërinë e regjistrimeve të fryra që nga regjistrimi në origjinë i tokës bujqësore.

b) Fillimisht verifikohen regjistrimet, duke filluar nga regjistrimi i fundit deri te regjistrimi i dytë, me përjashtim të regjistrimit të origjinës (për herë të parë të titullit të pronësisë).

c) Në rast se regjistrimet e përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike rezultojnë të kryera në përputhje me ligjin, atëherë vijohet me realizimin e shërbimit të aplikuar, dhe më pas bëhet verifikimi i regjistrimit në origjinë të pasurisë.

ç) Kur gjatë verifikimit rezulton se regjistrimi në origjinë i tokës bujqësore ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin për shkak se:

i) është kryer në bazë të akteve të marrjes së tokës në pronësi, me mungesë të një apo më shumë elementeve të formës apo përmbajtjes së tyre, të përcaktuar në pikën 1 të këtij ushëzimi;

ii) aktet e marrjes së tokës, në pronësi, nuk administrohen në zyrën e regjistrimit edhe pse regjistrimi rezulton i kryer;

iii) është kryer në bazë të AMTP-së, me shënimin “Dublikatë”;

iv) sipërfaqja e të gjitha pasurive të dhëna me AMTP, në total, del më e vogël se sipërfaqja e të gjitha këtyre pasurive, të dala gjatë regjistrimit fillestar dhe të pasqyruara në kartelat e pasurisë;

atëherë, konstatimet e kryera nga punonjësit, që përpunojnë praktikën, i referohen regjistruarit në formë të shkruar, duke treguar hollësisht mangësitë dhe shkakun e paligjshmërisë.

d) Kur janë konstatuar një apo më shumë nga mangësitë e përmendura në shkronjën “ç” të kësaj pike, me përjashtim të rasteve kur në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme AMTP-ja administrohet në fotokopje ose mungon, brenda 2 ditëve pune nga data e konstatimit, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronës (në vijim KV). Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkruese të faktit, argumentimin e mangësive/paligjshmërive të konstatuara dhe propozimin për verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën e bujqësore, me qëllim marrjen e një vendimi sipas nenit 9 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”. Relacionit detyrimisht i bashkëlidhet edhe një kopje e AMTP-së (kur gjendet në zyrën e regjistrimit) dhe të akteve/dokumenteve, që përmbajnë këto mangësi, si dhe një kopje e kartelës së pasurisë së mbajtësit të fundit të titullit të pronësisë, së bashku me gjenealitetet e tij dhe adresën, në rast se këto të dhëna administrohen në zyrën e regjistrimit.

dh) Në rastin kur në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme AMTP-ja administrohet në fotokopje ose mungon, ZVRPP-ja, brenda 2 ditëve pune, nga data e konstatimit, i drejtohet mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, komunës dhe SAMT-së, pranë këshillit të qarkut, me kërkesën që, nëse disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, ta paraqisin në ZVRPP.

e) Nëse brenda 15 ditëve kalendarike, nga data e protokollimit të kërkesës ZVRPP-ja nuk merr përgjigje apo merr përgjigje negative, çështja i dërgohet KV-së, brenda 2 ditëve pune nga data e konstatimit, sipas procedurës së parashikuar në shkronjën “dh” të kësaj pike.

ë) Nëse brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “e” në ZVRPP dërgohet AMTP-ja origjinale, ZVRPP-ja verifikon përputhjen e të dhënave të këtij akti me të dhënat në fotokopjen e AMTP-së dhe/ose kartelës, që ndodhet në zyrën e regjistrimit. Kur nga verifikimi konstatohet mospërputhje ndërmjet të dhënave, çështja i dërgohet KV-së, brenda 2 ditëve pune nga data e konstatimit, sipas procedurës së parashikuar në shkronjën “dh”.

2.2 Të tretët, të cilët e kanë përfituar pasurinë, të regjistruar në origjinë si tokë bujqësore, si rezultat i transaksioneve, nuk ndalohen të kryejnë veprime me pasuritë e tyre as gjatë periudhës së verifikimit të regjistrimit nga zyrat e regjistrimit dhe as gjatë verifikimit të ligjshmërisë apo edhe pas kontatimeve të mundshme të paligjshme së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore nga KV-ja.

2.3 Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pavarësisht se nuk mund t’i pengojnë të tretët në kryerjen e veprimeve mbi pasuritë, janë të detyruara, në çdo rast, të bëjnë verifikimin e regjistrimit në origjinë të tokës bujqësore.

2.4 Procedurat e përmendura në pikën 2.1 nuk zbatohen në rastin e tokave bujqësore, të transferuara te të tretët, që krijojnë mbivendosje me pasuri të tjera, të cilat nuk rrjedhin nga e njëjta origjinë. Në këtë rast zbatohen procedurat e udhëzimit nr.4, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve, të kryera në kundërshtim me ligjin, dhe atyre që krijojnë mbivendosje në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

2.5. Pasuritë e regjistruara në bazë të akteve/aktit të marrjes së tokës në pronësi, të transferuara te të tretët, për të cilat ka filluar një procedurë fshirjeje regjistrimi, për shkak të paligjshmërisë së regjistrimit, në bazë të udhëzimit nr.4, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve, të kryera në kundërshtim me ligjin, dhe atyre që krijojnë mbivendosje në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, nuk do të trajtohen sipas dispozitave

të udhëzimit të mësipërm, por sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

2.6. Kur pasuria e fituar me AMTP figuron ende në pronësi të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në rastet e trajtimit të kërkesave për shërbim të subjekteve të ndryshme veprojnë, si më poshtë vijon:

a) Verifikojnë, në zbatim të pikës 3 të udhëzimit nr.4 datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve, të kryera në kundërshtim me ligjin, dhe atyre që krijojnë mbivendosje në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, ligjshmërinë e regjistrimit, të kryer në origjinë, të tokës bujqësore.

b) Kur gjatë verifikimit rezulton se regjistrimi në origjinë i tokës bujqësore ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin, për një apo më shumë nga shkaqet e parashikuara në shkronjën “ç” të pikës 2.1 të këtij udhëzimi, procedohet sipas parashikimeve të bëra në atë pikë. Në këtë rast, bazuar në shkronjën “b” të nenit 44 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, regjistruesi nxjerr urdhër për kufizimin e veprimeve mbi pasurinë, deri në përfundim të procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, duke bërë shënimin në kartelën përkatëse të pasurisë.

c) Për pasuritë e regjistruara në bazë të akteve të marrjes së tokës në pronësi, ende në pronësi të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, për të cilat ka filluar një procedurë fshirjeje regjistrimi për shkak të paligjshmërisë së regjistrimit, në bazë të udhëzimit nr.4, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve, të kryera në kundërshtim me ligjin, dhe atyre që krijojnë mbivendosje në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, do të zbatohen dispozitat e këtij udhëzimi, dhe jo ato të udhëzimit nr.4, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve, të kryera në kundërshtim me ligjin, dhe atyre që krijojnë mbivendosje në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

3. Kur pasuria, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, nuk figuron e regjistruar në pronësi të përfituesit, me ATMP, dhe regjistrimi i saj do të bëhet:

a) gjatë procesit të regjistrimit fillestar sistematik të zonës kadastrale, ku ndodhet gjeografikisht pasuria;

b) me “kërkesë për regjistrim”, kur pasuria ndodhet në zona kadastrale, për të cilat ka përfunduar regjistrimi sistematik i pasurive;

c) me “kërkesë për regjistrim n[raste të veçanta”, kur pasuria ndodhet në zona kadastrale ku nuk ka filluar procesi i regjistrimit sistematik të pasurive;

Do të procedohet me regjistrimin e saj në favor të përfituesit më AMTP, si më poshtë:

3.1. për AMTP-në, të lëshuara nga komisionet e ndarjes së tokës përpara datës 15.8.2008, pasi të plotësohen njëherësh këto kushte:

i) AMTP -ja të përmbajë të gjitha elementet e formës dhe të përmbajtjes, të përcaktuara në pikën 1, të këtij udhëzimi;

ii) të mos jetë “Dublikatë”;

iii) ATMP-ja të përcillet zyrtarisht për regjistrim nga SAMT-i, pranë këshillit të qarkut, së bashku me planrilevimi/planvendosje dhe certifikatën e përbërjes familjare në datën 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, dhe 1.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore;

iv) Subjekti, në favor të të cilit është lëshuar AMTP-ja, të ketë aplikuar për regjistrim pasurie në ZVRPP.

Nëse nuk plotësohen kushtet e përmendura në këtë pikë, zbatohet procedura e refuzimit të regjistrimit, të parashikuara në udhëzimin nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

3.2. Për AMTP-të, të lëshuara nga komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, në zbatim të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë”, pasi të plotësohen njëherësh këto kushte:

i) AMTP-ja përmban elementet e përcaktuara me vendimin nr.224, datë 19.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve, të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)”

ii) AMTP-ja është përcjellë, së bashku me planvendosjen përkatëse, nga SAMT-ja pranë

këshilli të qarkut;

iii) Subjekti, në favor të të cilit është lëshuar AMTP-ja, të ketë aplikuar për regjistrim pasurie në ZVRPP.

Nëse nuk plotësohen kushtet e përmendura në këtë pikë, zbatohet procedura e refuzimit të regjistrimit, e parashikuar në udhëzimin nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

4. AMTP-të e lëshuara nga komisionet e ndarjes së tokës përpara datës 15.8.2008, të cilat nuk janë dorëzuar në ZRPP, duhet të përcillen për regjistrim nga SAMT pranë këshillave të qarqeve në ZVRPP përkat[se vetëm pasi të verifikohet nëse:

i) Përfituesi me AMTP ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore, sipas njërit nga aktet ligjore e nënligjore, të mëposhtme: të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” të ndryshuar, ligjit nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, vendimit nr.452, datë 17.10.1992 të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore”, të ndryshuar.

ii) AMTP-ja përmban të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 1, të këtij udhëzimi;

iii) Planvendosja është e konfirmuar nga komuna/bashkia përkaëtse.

4.1 Nëse nuk plotësohet ndënjëra nga kushtet e përmendura në nënndarjet “i”, “ii” e “iii”, të pikës 4, brenda 2 ditëve pune nga data e konstatimit, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronësisë (KV). Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkruese të faktit, argumentimin e mangësive/paligjshmërive të konstatuara dhe propozimin për verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore për marrjen e një vendimi sipas nenit 9 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”. Relacionit detyrimisht i bashkëlidhet edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/dokumenteve, që përmbajnë këto mangësi.

5. Komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë, me marrjen e kërkesës nga ZVRPP-të apo SAMT-të, pranë këshillave të qarqeve, shqyrton ligjshmërinë e krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore (AMTP) dhe procedon me marrjen e një vendimi sipas nenit 9 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

6. Për regjistrimin e së drejtës së përdorimit të tokave bujqësore, të fituar me AMTP, ZVRPP-të procedojnë gjatë ose pas regjistrimit sistematik të zonës kadastrale, në të cilën ndodhet gjeografikisht pasuria, nëse përmbushen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

i) AMTP-ja përmban të gjitha elementet e formës dhe të përmbajtjes, të përcaktuara në pikën 1, të këtij udhëzimi;

ii) AMTP-ja të mos jetë “Dublikatë”

iii) AMTP-ja, përcillet zyrtarisht për regjistrimin nga SAMT-ja pranë këshillit të qarkut, së bashku me planrilevin/planvendosje dhe certifikatën e përbërjes familjare në datën 1.10.1992;

iv) Subjekti, në favor të të cilit është lëshuar AMTP-ja, të ketë aplikuar për regjistrim të së drejtës së përdorimit në ZVRPP;

6.1 Aktet e marrjes së tokës në përdorim duhet të përcillen për regjistrim nga SAMT-ja, pranë këshillave të qarqeve, në ZVRPP-në përkatëse, vetëm pasi të verifikohet nëse:

i) përfituesi me akt të marrjes së tokës në përdorim ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore, sipas aktit ligjor apo nënligjor përkatës;

ii) akti i marrjes së tokës në përdorim përmbajn të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi;

iii) planvendosja është e konfirmuar nga komuna/bashkia përkatëse;

iv) akti nuk është “dublikatë”

7. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës pranë këshillave të qarqeve, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.316, datë 8.4.2009

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1712, DATË
24.12.2008 “PËR DHËNIEN ME QIRA OSE ENFITEOZË TË PASURIVE SHETËTËRORE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të kapitullit VIII të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1712, datë 24.12.2008 “Për dhënie me qira ose enfiteozë të pasurive shetëtorë”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

1. Procedurat e konkurrimit për dhënie me qira ose enfiteozë të pronës shetëtorë kryhen nga organi që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose enfiteozës.

2. Në zbatim të pikës 5-b, të kap.I-rë, institucioni që pajis subjekte private me leje shfrytëzimi të pasurive minerare, peshkimit, ujërave etj., plotëson dokumentacionin për dhënie me qira të aseteve, sipas përcaktimit në kapitullin e II-të, pika 1 të vendimit të cituar dhe e përcjell në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shqyrton dokumentacionin dhe autorizon në emër dhe për llogari të saj, institucionin që ka lëshuar lejen e shfrytëzimit për të lidhur dhe monitoruar kontratën e qirasë. Kontrata e qirasë lidhet për periudhë jo më të gjatë se afati i lejes së dhënë. Në kontratën e qirasë nuk përfshihet sipërfaqja e dhënë me leje shfrytëzimi, por sipërfaqja në funksion të ushtrimit të veprimtarisë për të cilën është licencuar.

3. Në zbatim të pikës 5-c, të kap.I-rë, subjekti paraqet në METE kërkesën për kontratë huapërdorje për sipërfaqen e ndërtimit të fabrikave, biznesplanin e paraqitur për marrjen e lejes së shfrytëzimit, të shoqëruar me dokumentacionin si vijon:

- lejen për ndërtimin e fabrikës lëshuar nga organi që e ka në kompetencë,
- genplanin e sipërfaqes ku do të ndërtohet fabrika, ku të jetë i qartë sheshi i ndërtimit dhe shfrytëzimit, në 5 kopje,
- kopje të noterizuara të lejes së shfrytëzimit, marrëveshjes minerare dhe biznesplanit, etj.

4. Në zbatim të pikës 5-ç, të kapitullit të I-rë, në kontratat e qirasë ose enfiteozës të lidhura me sipërfaqe mbi 500 m², mund të bëhet pa konkurrim shtesë në sipërfaqen e marrë në përdorim deri në 500 m², pasi subjekti qiramarrës ose enfiteozëmarrës do të paraqesë kërkesën për shtesë, ndërsa institucioni që ka në administrim objektin do të paraqesë miratimin e organit drejtues dhe genplanin e sipërfaqes shtesë të përgatitur sipas pikës I-b të kapitullit të II-të, të vendimit të cituar. Llogaritja e detyrimit të qirasë për sipërfaqen shtesë bëhet sipas tarifave të zbatuara në kontratën bazë.

5. Në zbatim të pikës 6-a të kapitullit të I-rë, ndërmarrja, shoqëria apo institucioni shetëtor mund të lidhë kontrata qiraje mbi një vit, por jo më shumë se 5 vjet, pas miratimit me shkrim nga organi i varësisë administrative.

6. Në zbatim të pikës 1-ç të kapitullit të II-të, genplanin duhet të jetë në pesë kopje dhe mund të jetë i miratuar edhe nga urbanistika e prefekturës.

7. Te kapitulli i II-të, në pikën 1, kërkesa për pikën “e” do të plotësohet vetëm në rastet kur do të jepen me qira makineri, linja teknologjike, pajisje etj.

8. Në zbatim të pikës 5 të kapitullit të III-të, me truell të lirë do të kuptohen rastet kur sipërfaqja është shesh i lirë dhe nuk është pjesë funksionale e ndonjë objekti ndërtimor.

9. Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të kapitullit IV-të, për përfitimin të zbritjes së detyrimit mujor, Qiramarrësi i paraqet Qiradhënësit kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

- a) Vërtetim për punësimin mesatar vjetor të realizuar në vitin përkatës, lëshuar nga institucionet shetëtorë përkatëse,
- b) Raport i ekspertit kontabël për investimet e realizuara nga Qiramarrësi në objektin e marrë me qira dhe të paraqitura në bilanci financiar të shoqërisë Qiramarrëse.
- c) Bilancin financiar të shoqërisë Qiramarrëse për vitin përkatës, të dorëzuar në Degën e Tatimeve.

Zbritja e detyrimit mujor për nivelin e punësimit të realizuar mbrohet çdo vit nga Qiramarrësi me dokumentacionin përkatës, ndërsa zbritja e detyrimit mujor për nivelin e investimit të realizuar

vlen deri në përfundim të kontratës. Kur treguesit e realizuar ndryshojnë nga viti paraardhës, miratohet koeficienti zbritës i ri sipas akteve ligjore në fuqi në atë moment.

10. Në zbatim të pikës 3 të kapitullit IV-të të vendimit, procedohet si vijon:

Organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit, pasi shqyrton propozimet e përgatitura sipas pikës 1, në kapitullin e II-të të këtij vendimi, i propozon Këshillit të Ministrave për rastet kur është në interes të aplikohet kontrata me tarifë 1 euro, për ushtrim të aktivitetit prodhues. Me daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave për kontratën me tarifën 1 euro, organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit fillon procedurat sipas pikave të tjera në kapitullin e II-të të vendimit të cituar dhe kriterëve të përcaktuara në vkm-në e mësipërme.

Subjekti që fiton të drejtën e lidhjes së kontratës me tarifën 1 euro, para firmosjes së saj depoziton një vlerë garancie kontrate në masën 10% të vlerës së investimit të marrë përsipër në konkurrim.

11. Në zbatim të pikës 2 të kapitullit të VII-të, të vendimit të cituar, për rastet kur truallit ku shtrihet pasuria e ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore e dhënë me kontratë qiraje ose enfiteozë i është kthyer ose njohur pronarit, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, pronarit i lind e drejta të përfitojë vlerën e qirasë së truallit. Për këtë procedohet si vijon:

a) Pronarët që kanë një vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për kthimin ose njohjen e truallit të dhënë në përdorim të tretëve me kontratë qiraje ose enfiteozë, paraqesin në institucionin që ka lidhur kontratën, kërkesën për përfitimin e vlerës së qirasë së truallit, të shoqëruar me një kopje të vendimit të KKP-së. dhe genplanin përkatës, apo çdo dokument tjetër ligjor të regjistruar në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që përcakton se është pronar i truallit, të noterizuara.

b) Organi shtetëror që ka lidhur kontratën e qirasë ose enfiteozës, kërkon nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, konfirmim në lidhje me pronësinë e atij truallit, si dhe regjistrimet e bëra mbi atë pronë, nëse ka të tilla.

c) Organi shtetëror që ka lidhur kontratën e qirasë ose enfiteozës, kërkon nga Zyra Rajonale e Agjencisë së Kthimit e Kompensimit të Pronave, konfirmim në lidhje me këtë vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave ish Pronarëve së bashku me ndryshimet e bëra atij në vitë (nëse ka të tilla), si dhe saktësimin e sipërfaqes së truallit që është kthyer ose njohur pronarit dhe që është pjesë e kontratës së qirasë ose enfiteozës.

d) Në rastet kur Zyra Rajonale e Agjencisë së Kthimit e Kompensimit të Pronave nuk është në gjendje të bëjë saktësimin e sipërfaqeve të truallit të kthyer ose njohur pronarëve me sipërfaqen e truallit ku shtrihet pasuria e dhënë me qira ose enfiteozë, ndërmarrja ose institucioni që ka në administrim objektin bën saktësimin dhe mbivendosjen me ekspertë, e konfirmon atë në organin e qeverisjes vendore (zyrat e urbanistikës) dhe e dërgon në organin që ka lidhur kontratën.

e) Me skatësimin e dokumentacionit për pronësinë e truallit, midis Qiradhënësit dhe pronarit të truallit ose grupit të bashkëpronarëve të truallit, ose subjektit të autorizuar prej tyre, lidhet një kontratë ku përcaktohet vlera e qirasë së truallit që përfiton subjekti i shpronësuar dhe mënyra e tërheqjes së saj. Pronari i truallit përfiton të drejtën e vlerës së qirasë vetëm për atë pjesë të truallit që është i mbivendosur në sipërfaqen e përgjithshme të shprehur në kontratën e qirasë ose enfiteozës. Vlera e qirasë që përfiton pronari i truallit llogaritet si shumë e vlerës së qirasë së truallit të lirë funksional me vlerën e qirasë së truallit nën ndërtesë.

f) Dosja përkatëse për çdo rast do të ketë dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesën e pronarit të truallit, ose grupit të bashkëpronarëve të truallit, ose subjektit të autorizuar prej tyre;

- Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që ka kthyer ose njohur të drejtën e pronësisë, shoqëruar me genplanin përkatës, të noterizuara,

- Konfirmimin e Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave,

- Konfirmimin e Zyrës së Rregjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme,

- Genplanin e objektit të dhënë me qira ose enfiteozë,

- Çdo dokument tjetër plotësues që ka shërbyer për verifikim të pronësisë mbi pronën.

g) Ndërmarrja ose Institucioni shtetëror ku qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi derdh vlerën e detyrimit të qirasë, pasi kalon në llogari të pronarit të truallit, vlerën e përcaktuar në marrëveshje, bën shpërndarjen e të ardhurave nga qiratë sipas përcaktimeve në kapitullin VI të vendimit të cituar.

12. Në zbatim të pikës 4 të kapitullit të VII-të, për kontratat e lidhura me sipërfaqe mbi 500 m², me kërkesë të subjektit qiramarrës ose enfiteozëmarrës, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës urdhëron ngritjen e grupit të ekspertëve të përbërë nga një ekspert vlerësimi pasurie dhe një ekspert kontabël, të cilët bëjnë vlerësimin e investimeve të kryera nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi për periudhën nga lidhja e kontratës deri në bilancin e vitit të fundit ushtrimor të miratuar, hartojnë raportin përfundimtar dhe e dërgojnë për miratim te urdhëruesi.

Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike bën krahasimin ndërmjet vlerës së investimit dhe vlerës së truallit, sipas çmimit të truallit të konfirmuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Kur vlerat e krahasuara vërtetojnë se investimet e kryera janë mbi 150 përqind e vlerës së truallit, DAPP përcjell në Drejtorinë e Privatizimit dosjen e cila përmban: kontratën e qirasë ose enfiteozës, kërkesën e subjektit për blerje të drejtpërdrejtë, raportin e miratuar të grupit të ekspertëve për vlerësimin e investimeve, konfirmimin e Agjencisë së Kthimit të Pronave për çmimin e truallit.

Drejtoria e Privatizimit ndjek procedurat e privatizimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.317, datë 8.4.2009

PËR PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË SHOQËRIVE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” të ndryshuar, ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

1. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, procedurat bëhen në përputhje me seksionin V, “Likuidimi”, të kreut VI “Dispozita të përbashkëta për të gjitha format e shoqërive”, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Operacionet e likuidimit kryhen nga likuidatori, i cili përfaqëson shoqërinë, dhe ka për objekt mbylljen e llogarive dhe çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3. Me kalimin e shoqërisë në likuidim hartohet bilanci i likuidimit, i cili verifikohet dhe

vërtetohet nga eksperti kontabël i autorizuar. Bilanci, për efekt likuidimi, miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shërben si pikënisje për identifikimin e aseteve, elemente të pasurisë, që do të likuidohet.

4. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, shiten nëpërmjet ankandit publik, pas publikimit në Buletinin e Njoftimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik. Njoftimi për shitje bëhet katër herë radhazi, nga data e dërgimit të njoftimit për shitje, si dhe vendoset edhe në mjediset e shoqërisë e në objektin, që do të shitet. Njoftimi në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet dhe ndiqet nga Autoriteti Shitës, ku do të bëhet edhe shpërndarja e dokumenteve personave të interesuar.

5. Ankandet për shitjen e pasurive të shoqërive tregtare shtetërore në likuidim bëhen në mjediset e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Komisioni i ankandit përbëhet nga jo më pak se 3 veta, të cilët përcaktohen me urdhër të likuidatorit të shoqërisë. Dy të tretat e anëtarëve të komisionit të ankandit caktohen me autorizim të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

7. Bazuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, në ankandet për shitjen e pasurive të këtyre shoqërive nuk zbatohet, për ish-pronarët, e drejta e parablerjes. Ata marrin pjesë në ankand si të gjithë të tjerët. Në rastet e shpalljes fitues, ish-pronarëve u zbritet vlera e truallit, e njohur dhe e kthyer me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

8. Gjatë zhvillimit të ankandit mbahet procesverbal, ku evidentohen emrat e anëtarëve të komisionit të ankandit, emrat e konkurruesve në ankand dhe emri i personit të shpallur fitues. Fituesi lidh kontratë për blerjen e objektit, pas pagesës së plotë të vlerës së objektit, përfshirë dhe TVSH (20%), për asetet, që janë objekt i saj. Pagesa në asnjë rast nuk mund të bëhet me letra me vlerë ose bono privatizimi. Me lidhjen e kontratës, likuidatori bën dorëzimin e objektit, nëpërmjet aktit të dorëzimit.

9. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nuk paguan brenda 30 ditëve nga data e shpalljes fitues, vlerën e çmimit të arritur në ankand, ai e humbet të drejtën e blerjes, si dhe të marrjes pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

10. Vlera fillestare e ankandit për shitjen e objekteve, të truallit dhe makinerive e pajisjeve është vlera e përcaktuar nga ekspertët vlerësues, të emëruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë, në përputhje me çmimet e tregut. Kësaj vlere i shtohet vlera sipas kontabilitetit e inventarit ekonomik, si dhe vlera e mjeteve të xhiros të objektit përkatës.

11. Likuidatori ngre një komision për vlerësimin e mjeteve të xhiros si më poshtë vijon:

a) Artikujt e grupit “a”, që kanë vlerë tregtimi me qarkullim normal, vlerësohen me çmimin e shitjes me shumicë në treg.

b) Artikujt, që kanë vlerë tregtimi, por me qarkullim të ngadalshëm, vlerësohen me vlerën kontabël të mbetur.

c) Artikujt e grupit “c”, që nuk gjejnë treg shitjeje, vlerësohen me vlerën kontabël, që kanë pasur në kohën kur kanë hyrë në magazinë shumëzuar me koeficientin 0.1.

ç) Për metalet me ngjyrë, si bakri, alumini, plumbi, zinku, kallaji, nikeli, ari dhe argjendi, vlera fillestare e ankandit, për rastet kur çmimi në treg është më i lartë se vlera kontabël e tyre në bilanc, llogaritet referuar çmimit të bursës së Londrës (LME). Në rast se nuk realizohet shitja me vlerën e llogaritur sipas LME-së, shoqëria cakton vlera të reja, deri në vlerën kontabël të mallit.

12. Raportet e vlerësimit të ekspertëve vlerësues, si dhe raportet e komisionit miratohen para publikimit, nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

13. Para publikimit të objektit për shitje, shoqëria kërkon, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, hartën treguese përkatëse.

14. Në rast se nuk realizohet shitja me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, objekti publikohet për herë të dytë, me 70 për qind të vlerës së përcaktuar në fillim, duke i shtuar kësaj vlere

edhe vlerën e trualtit, të përcaktuar nga ekspertët vlerësues, si dhe 50 për qind të vlerës së inventarit ekonomik dhe të mjeteve të xhiros. Nëse edhe me këtë vlerë nuk shitet, atëhere publikohet me vlerë kontabiliteti. Nëse nuk shitet as me vlerën sipas kontabilitetit, atëhere vendos Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

15. Makineritë dhe pajisjet, që nuk kanë mundur të shiten me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, publikohen për herë të dytë me 50 për qind të vlerës së përcaktuar në fillim. Në rast se shitja nuk realizohet zbatohen procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Të ardhurat e realizuara nga likuidimi, si shitja e aseteve, arkëtimi i debitorëve, të ardhurat nga qiraja apo edhe fitime të tjera, shërbejnë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërisë në likuidim, në mënyrë proporcionale në varësi të mjeteve monetare të siguruara. Përfshihen nga ky rregull detyrimet fiskale dhe ato sociale (paga dhe sigurime shoqërore), të cilat do të shlyhen tërësisht. Për kërkesat debitoare, të paarkëtueshme, si në rastin, kur debitorët nuk ekzistojnë, kur kërkesat nuk janë të dokumentuara apo është humbur procesi gjyqësor etj., procedohet, duke i kaluar si shpenzime likuidimi.

17. Likuiditori nuk mund të lidhë kontrata dhe as nuk mund të shesë asete me mirëkuptim, pa autorizimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

18. Në publikimin për shitje të pasurisë së shoqërisë në likuidim përfshihen edhe objektet e dhëna me qira, përpara datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim.

19. Llogaritë vjetore depozitohen në formën dhe në afatet e parashikuara në ligjin nr.9228, datë 29.4.2008 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

20. Anulohen të gjitha miratimet e privatizimit të aseteve të përfshira në kapitalin e shoqërisë që nuk kanë filluar procedurën e përgatitjes së dokumentacionit para datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim me vendim gjyqi.

21. Udhëzimi nr.69, datë 29.1.2009 “Për shoqëritë Anonime në likuidim e sipër, me kapital shtetëror” i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.318, datë 8.4.2009

PËR EMËRIMIN, FUNKSIONIMIN DHE SHPËRBLIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS NË SHOQËRITË ANONIME SHTETËRORE

Mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”,

UDHËZOJ:

I. Kriteret dhe përbërja e këshillit mbikëqyrës

1. Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime është si më poshtë:

- Për shoqëritë e vogla dhe të mesme, tre anëtarë.

- Për shoqëritë që veprojnë në sektorët strategjikë me rëndësi të veçantë, gjashtë anëtarë.

2. Përbërja e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga të cilët:

2/3 e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës propozohen nga ministritë e linjës administrative, ndërsa 1/3 propozohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Kandidati për anëtar në këshillin mbikëqyrës duhet të plotësojë, kriteret si më poshtë:

a) Të jetë punonjës i institucioneve shtetërore qendrore, që kanë administrim të drejtpërdrejtë me sektorin ku bën pjesë shoqëria, kur legjislacioni nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të

tjera.

b) Mund të jetë specialist i institucioneve kërkimore shkencore, pedagog i universiteteve Shtetërore, me vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet, si dhe persona që gëzojnë autoritet profesional në fusha të caktuara.

4. Nuk mund të emërohen anëtar në këshillat mbikëqyrës:

a) Punonjës të organeve shtetërore, qendrore a vendore, që kryejnë funksione kontroll revizioni.

b) Punonjës që janë emëruar anëtarë në drejtoritë e shoqërive tregtare, si dhe punonjës që janë emëruar drejtorë në ndërmarrjet shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare.

c) Kushdo që ka konflikt interesash, sipas përcaktimit në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

d) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri.

II. Emërimi i këshillit mbikëqyrës

1. Ministria e linjës, në përputhje me raportin pjesëmarrës në përbërjen e këshillit mbikëqyrës, paraqet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës kandidaturat e saj në një periudhë 15-ditore nga marrja e kërkesës.

2. Kandidaturat shoqërohen detyrimisht me CV-të përkatëse.

3. Për përfaqësuesin e METE-s kandidaturat paraqiten nga drejtues të dikasterit.

4. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike përgatit urdhrin për emërim ose ndryshim, i cili firmoset nga Ministri i METE-s ose i autorizuari i tij.

5. Me propozim të Ministrit të METE-s (të autorizuarit të tij), këshilli mbikëqyrës, në mbledhjen e tij të parë zgjedh me shumicë votash kryetarin dhe nënkryetarin. Këshilli mbikëqyrës mund të caktojë gjithashtu edhe një sekretar, me një shpërblim mujor deri në 15 000 lekë për shoqëritë strategjike dhe deri në 5 000 lekë për ato jostrategjike. Sekretari i këshillit mbikëqyrës do të jetë përfaqësues i shoqërisë apo përfaqësues i METE-s.

6. Kryetari i këshillit mbikëqyrës (në mungesë të tij, nënkryetari) ka këto detyra:

a) Thërret dhe drejton mbledhjen e këshillit mbikëqyrës sipas rendit të ditës të përcaktuar.

b) Cakton detyra të veçanta për anëtarët e këshillit (kur e gjykon të nevojshme).

c) Firmos në emër të këshillit mbikëqyrës kontratën “Për administrimin e shoqërisë” me drejtorinë e shoqërisë, firmos vendimet e këshillit mbikëqyrës, informacione dhe çdo lloj shkresë që duhet të drejtohet në METE dhe ministrinë e linjës.

7. Ministria e linjës është e detyruar të njoftojë menjëherë METE-s në rastet kur anëtari i këshillit mbikëqyrës, përfaqësues i tij, pëson ndryshime, për të cilat legjislacioni pengon pjesëmarrjen në këshillin mbikëqyrës, duke propozuar edhe zëvendësuesin e tij.

8. Këshilli mbikëqyrës emërohet për mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

9. Nëse një anëtar i këshillit mbikëqyrës nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi, atëherë Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës merr vendimin për lirim të tij nga detyra.

III. Procedurat për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës e zhvillon veprimtarinë nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve të tij mbi bazën e një programi vjetor të miratuar për aktivitetin e drejtorisë dhe të mbledhjeve të tjera të posaçme të kërkuara nga vetë këshilli apo drejtoria.

2. Kryetari i këshillit mbikëqyrës përcakton rendin e ditës së mbledhjes së këshillit mbikëqyrës në bazë të programit vjetor të miratuar si më lart. Ai përcakton kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.

3. Drejtoria e sh.a.-së mund të kërkojë shqyrtimin nga këshilli mbikëqyrës edhe të problemeve të tjera të rëndësishme, që dalin gjatë veprimtaritë së zakonshme e që nuk janë parashikuar në programin vjetor, të cilat mund të shtohen në rendin e ditës të përgatitur nga këshilli mbikëqyrës.

4. Raportet dhe materialet e përgatitura për t’u paraqitur në mbledhjen e këshillit mbikëqyrës sipas rendit të ditës të miratuar, u dorëzohen anëtarëve të këshillit mbikëqyrës nga drejtuesit e shoqërisë 10 ditë para mbledhjes. Ndryshimet në kohë bëhen vetëm me miratimin e kryetarit.

5. Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit mbikëqyrës dokumentohet në librin e protokollit nga sekretari i këshillit mbikëqyrës. Mbi bazën e protokollit të mbajtur zbardhen vendimet e këshillit mbikëqyrës.

6. Në raste të veçanta me miratimin e kryetarit të këshillit mbikëqyrës diskutimet regjistrohen

në kaseta. Protokolli dhe kasetat me regjistrimet e mbledhjeve, janë dokumente për përdorim të brendshëm dhe ruhen nga sekretari i këshillit mbikëqyrës, sipas akteve ligjore e nënligjore mbi arkivat.

7. Një kopje e vendimeve të këshillit mbikëqyrës dërgohet në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike në METE.

8. Drejtori i shoqërisë, para mbledhjes së radhës informon këshillin mbikëqyrës mbi realizimin e detyrave të lëna në mbledhjen e mëparshme.

IV. Kompetencat e këshillit mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës është organ vendimmarrës në shoqëri. Ai ushtron kontroll të vazhdueshëm ndaj drejtorisë e cila administron shoqërinë. Këshilli mbikëqyrës mund të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole, të njihet me dokumente që i gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij.

2. Këshilli mbikëqyrës, me 2/3 e gjithë anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, përcakton numrin e anëtarëve të drejtorisë, emëron anëtarët e drejtorisë dhe me miratimin paraprak të Ministrit të METE-s (asamblesë), ngarkon njërin prej anëtarëve të saj me cilësinë e drejtorit të përgjithshëm. Në vendimin për emërim në detyrë, përcaktohet edhe paga e drejtorit të shoqërisë dhe anëtarëve të tjerë, në përputhje me aktet ligjore për këtë qëllim dhe në varësi të situatës financiare të shoqërisë.

3. Këshilli mbikëqyrës mund të shkarkojë secilin prej tyre për shkaqe të përligjura ose kur Ministri i METE-s (asambleja) humbet besimin tek ai.

4. Këshilli mbikëqyrës miraton:

a) Strukturën e shoqërisë.

b) Rregulloren e funksionimit të saj.

c) Drejtoria e shoqërisë merr miratim nga këshilli mbikëqyrës për dhënien me qira të objekteve.

5. Këshilli mbikëqyrës i propozon Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës lidhur me këto çështje:

a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë.

b) Hapjen e veprimtarive ose njërive të reja dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë.

c) Shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë.

d) Pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera.

e) Marrjen e huajve afatmesme dhe afatgjata.

f) si dhe çdo çështje tjetër, që në bazë të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” është kompetencë e asamblesë së përgjithshme.

6. Këshilli mbikëqyrës lidh kontrata vjetore me drejtorinë për administrimin e shoqërisë. Përcakton nivelin e njësisë së auditimit të brendshëm, në përputhje me ligjin nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm” dhe aktet nënligjore. Emëron kryetarin e njësisë së auditimit, miratimin e programit vjetor të auditimit dhe kontrollon zbatimin e tij çdo tremujor.

7. Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar, për verifikim e kontroll shqyrton raportin e drejtorisë dhe të ekspertit kontabël të autorizuar. Pas miratimit, materiali paraqitet në ministrinë.

V. Shpërblimi i këshillit mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës përfiton shpërblim mujor për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës. Shpërblimi fillon nga mbledhja e parë, e cila përballohet nga shoqëria. Shpërblimi jepet sipas përcaktimit në pikën 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të sh.a.-ve shtetërore”.

2. Kryetari dhe anëtarët e këshillave mbikëqyrës deklarohen vetë me shkrim në drejtorinë e shoqërisë për shpërblimin për pjesëmarrje në këshillin e parë apo të dytë. Këshilli i dytë shpërblehet në masën 75% të shumës së përcaktuar sipas rastit në pikën 6/a,b,c,d.

3. Për detyra të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të ngarkuara nga këshilli mbikëqyrës, të vërtetuara në materiale e dokumente shkresore, anëtarit t’i rimburohet vlera e shpenzimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Udhëzimi nr.29, datë 13.1.2006 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, shfuqizohet.

Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.44, datë 17.4.2009 në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.336, datë 15.4.2009 “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë “ të bëhet korrigjimi në numrin e vendimit si më poshtë:

Është: VKM nr.336, datë 15.4.2009

Bëhet: VKM nr.366, datë 15.4.2009

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.4.2009
Doli nga shtypi më 24.4.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 16 lekë